



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 5
Prishtinë, më 17. 3. 2015, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: znj. Teuta Rugova, znj. Blerta Deliu-Kodra, z. Elmi Reçica, z. Ismet Beqiri dhe znj. Puhie Demaku.

Munguan: z. Enver Hoxhaj, z. Qerim Bajrami, z. Ramush Haradinaj dhe z. Zafir Berisha.

Delegacioni nga Qipro ishte në përbërje: znj. Louiza Hadjivasiliou, z. Michalis Avraam, z. Lozos Loukaidis, znj. Seyis Thompson, z. Meltem İkinci, z. Pavlos Koktsidis.

Pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati-ZPRK, Sanije Berisha- OSBE, Gurjeta Zeka-LVV dhe Elton Bellopoja-NDI.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Takimin e kryesoi: Teuta Rugova, zëvendëskryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

Takim i Komisionit me delegacionin nga Qipro

Teuta Rugova delegacionit nga Qipro, i dëshiroi mirëseardhje në takim të përbashkët me anëtarët e Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Këtë takim, tha ajo se e konsideron shumë të frytshëm dhe me shpresë që përmes këtij delegacioni, zëri i deputetëve do të përcillet dhe do të ndikojë në raportet në mes të dy vendeve tona. Më tej ajo theksoi se Kosova po ecë drejt integritetit, por në këtë rrugëtim ende i nevojitet përkrahja dhe mbështetja e miqve tanë ndërkombëtarë, sidomos është e domosdoshme njohja edhe nga pesë vendet e BE-së, të cilat ende nuk e kanë njohur Kosovën, e që në mesin e tyre është edhe Qipro.

Michalis Avraam njoftoi se delegacioni është i përbërë nga përfaqësues të shoqërisë civile të Qipros. Ai shprehu kënaqësinë që gjenden këtu dhe theksoi se nuk merren me politikën e jashtme të Qipros por me promovimin e parimeve që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, ligjet ndërkombëtare dhe me promovimin e demokracisë. Brenda këtij fushëveprimi, ai tha se do të shikojmë mundësitë që të bashkëpunojmë më afër me organizatat joqeveritare në Kosovë.

Puhie Demaku theksoi se këtë takim e konsideroj shumë të rëndësishëm, ndërsa për shoqërinë civile tha se është një shtyllë e rëndësishme që ka ndikim të madh në shoqëri. Demaku kërkoi të informohet nga të pranishmit se si shihet Kosova në Qipro, cili është disponimi i politikanëve që ta njohin shtetin e Kosovës dhe si e shohin ata procesin e integritetit të Kosovës në BE.

Michalis Avraam duke u ndërlidhur me pyetjet e deputetes Demaku, tha se nuk e paraqesin qëndrimin e shtetit të tyre, por nuk pritet që të ketë ndryshime radikale lidhur me qëndrimin e politikës së jashtme të Qipros. Duhet të krijohen lidhje bashkëpunimi në mes të shoqërisë civile të Qipros dhe asaj të Kosovës, duke bërë të ditur se nuk ekziston një ndjenjë e keqe sa i përket Kosovës në Qipro.

Ismet Beqiri theksoi se qytetarët e Qipros si dhe shoqëria civile kanë nevojë të njoftohen me realitetin dhe me zhvillimet në Kosovë. Pa marrë parasysh specifikat e shtetit të Qipros, ato nuk paraqesin arsye që realiteti i cili shihet në Kosovë të paraqitet drejt.

Beqiri e njoftoi delegacionin se Kosova është ndër shtetet e rralla që bën një lloj diskriminimi pozitiv në aspektin e realizimit të të drejtave të komunitetit jo shumicë. Me rregullimin kushtetues në Kosovë, Kuvendi ka 120 deputetë, nga të cilët 20 vende janë të rezervuara për komunitetet pakicë e po ashtu edhe 30% e përfaqësimit janë femra, për të cilat çështje tha se ndihemi mirë.

Blerta Deliu Kodra tha se këtë takim e konsideroj një pikënisje të mirë në mes të shoqërisë civile dhe politikës kosovare, nga fakti se do të jepet një pasqyrë e qartë e realiteti kosovar, e cila mund të shfrytëzohet nga shoqëria civile e Qipros. Kosova, tha ajo është një shtet i ri, ku po punohet shumë në promovimin e të drejtave të njeriut, të drejtave të komuniteteve, në promovimin e demokracisë dhe të çështjeve gjinore, vlera të cilat janë të promovuara edhe në Kushtetutën dhe ligjet tona. Deliu shprehu dëshirën për një takim në Qipro, me qëllim të thellimit të bashkëpunimit, në mes të dy parlamenteve.

Elmi Reçica theksoi se që nga konstituimi i Komisionit, kjo është një ndër vizitat dhe takimi më i rëndësishëm dhe më me peshë, për shumë arsye. Kosova është shtet i ri dhe ka nevojë të njihet nga të gjitha vendet e posaçërisht nga pesë vendet e BE-së, që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e saj. Këtë vizitë të delegacionit nga Qipro, Reçica tha se e kuptojmë si një vizitë të qëllimit të mirë, që delegacioni ta njoh Kosovën nga brenda se si funksionon dhe pastaj të reflektojë me punën e tij kur të kthehet në Qipro. Nga delegacioni nuk mund të kërkohet që ta njeh pavarësinë e Kosovës, pasi që nuk është në kompetencë të tij, por të pasqyrohet realiteti çfarë është në Kosovë.

Ai shprehu gatishmërinë, qoftë si Komision apo edhe si qytetarë të jenë në dispozicion për të këmbyer kontakte qoftë përmes vizitave turistike, shkëmbimeve kulturore, për ndonjë takim informativ me qytetarët e Qipros, apo për çfarëdo lëvizje tjetër që shihet e arsyeshme.

Lozos Loukaidis theksoi se është e rëndësishme për shoqëritë civile, që të kenë kontakte me parlamentin. Në Qipro shoqëria civile nuk ka qasje në parlament, përderisa bashkëpunim i shoqërisë civile me Parlamentin në Kosovë ekziston dhe ky duhet të jetë shembull për vendet e rajonit. Propozoj që të punohet në një projekt që ka të bëjë me ofrimin e njerëzve të komuniteteve të ndryshme në Kosovë dhe Qipro, ngase njerëzit në Qipro nuk janë të informuar për situatën në Kosovë, tha Loukaidis.

Puhie Demaku tha se është shumë e rëndësishme për ne që pavarësia e Kosovës të njihet dhe të krijohen marrëdhënie me qytetarët e vendeve që akoma nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Ajo theksoi se është e nevojshme që shoqëria civile t'i shtyjë përpara disa procese dhe njerëzit të shohin se cili është potenciali i Kosovës.

Michalis Avraam njoftoi se Qipro nuk ka pasur qëndrim negativ sa i përket anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare dhe nuk i ka penguar proceset, por ka qëndruar e heshtur, duke theksuar se po shihet që Kosova ka potencial, por ka edhe probleme që i brengosin të dyja shtetet, prandaj duhet gjetur projekte për shoqërinë civile me qëllim të promovimit të interesave e qëllimeve të të dyja shteteve.

Teuta Rugova bëri të ditur se shoqërisë civile pas luftës në Kosovë i është dhënë një hapësirë shumë e madhe dhe se në të ardhmen do t'i jepet edhe më shumë dhe shprehu gatishmërinë për bashkëpunim edhe me shoqëritë civile të vendeve të tjera.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Enver Hoxhaj